

Përshëndetje z. Matlija,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, të përcjellë në adresën elektronike të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës 1 janar 2025 – 23 dhjetor 2025, ka realizuar rreth 21(njëzetë e një) udhëtime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen vizita zyrtare, pjesëmarrje në samite dhe konferenca ndërkombëtare.

Këto vizita kanë pasur si destinacion Malin e Zi, Kosovën, Azerbajxhanin, Austrinë, Bullgarinë, Poloninë, Vatikanin, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italinë, Spanjën, Maqedoninë e Veriut, Hungarinë, Egjiptin.

Për sa i përket aktiviteteve ndërkombëtare, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, ka marrë pjesë në samite dhe konferenca ndërkombëtare të ndryshme, jashtë vendit, në destinacionet Azerbajxhan, Bullgari, Poloni, SHBA, Spanjë dhe Katar.

Gjatë këtyre vizitave dhe aktiviteteve zyrtare, Presidenti i Republikës së Shqipërisë shoqërohet nga një delegacion zyrtar, i përbërë nga këshilltarë sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, si dhe stafi teknik, të angazhuar në funksion të përmbushjes së detyrave institucionale dhe mbarëvajtjes së aktiviteteve të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Shpenzimet për bileta avioni dhe akomodim për udhëtimet jashtë vendit, të realizuara gjatë periudhës 01.01.2025 – 23.12.2025 janë të publikuara në faqen zyrtare të institucioneve përgjegjëse për shpenzimet buxhetore.

Faleminderit!